

VENDIM
Nr. 42, datë 7.4.2015

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR MODIFIKIMIN E LICENCËS ME NR. 138,
SERIA PV11K PËR PRODHIMIN E ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC-ET E
“PELLGUT TË OKSHUNIT”, ME FUQI 31,489 MW, TË SHOQËRISË “DITEKO”
SHPK TË MIRATUAR ME VENDIMIN E BORDIT TE KOMISIONERËVE TË ERE-S
NR. 114 DATË 16.11.2011**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 19, të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, pikat 2.3 dhe 2.4 të “Licencës për prodhimin e energjisë elektrike”, si dhe neneve 10, 15 pikat 1 dhe 2 germa “b”, pika 4 germa “a” dhe “b”, të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, dhe nenit 18 pika 1, germa “a”, të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 21, datë 18.3.2009, të Bordit të Komisionerëve, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 7.4.2015, mbasi shqyrtoji relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Diteko” sh.p.k., plotëson kërkesat ligjore siç kërkohen nga rregullorja “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë /të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Neni 15, pika 4, germa “a”: Informacioni me shkrim ku janë shpjeguar arsyet e kërkesës për modifikimin e licencës. I plotësuar në mënyrë korrekte.

- Neni 15, pika 4, germa “b”: Mungon vendimi me shkrim i organeve drejtuese të të licencuarit të cilat shprehin vullnetin për të kërkuar modifikim licence.

Për dokumentacionet e munguara, do të njoftohet subjekti, bazuar në nenin 10, pika 10, neni 11, pika 1 të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, t’i paraqesë në ERE brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për modifikimin e licencës me nr. 138, seria pv11k, për prodhimin e energjisë elektrike nga HEC-et e “Pellgut të Okshunit” me fuqi 31,489 MW, të shoqërisë “Diteko”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 114, datë 16.11.2011.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti